



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 22.10.2018, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të datave 10.10.2018 dhe 15.10.2018.
2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Zogaj (Republika e Shqipërisë) – Skje (Mali i Zi) për qarkullimin ndërkombëtar rrugor dhe të pasagjerëve në liqenin e Shkodrës”.
3. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Bashkimit Europian për bashkëpunimin e zbatimit të ligjit, për vendosjen e oficerit ndërlidhës të EUROPOL-it”.

#### **Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina, Xhemal Qefalia.

#### **Mungojnë:**

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Silva Caka, Astrit Veliaj dhe Tom Doshi.

#### **Të ftuar:**

Rovena Voda - Zëvendësministre e Brendshme.

Xhevahir Karaj - Drejtor i Kufirit në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin.

Shkëlzen Rexhepi- Shefi i Zyrës Kombëtare të EUROPOL-it;

Anisa Boci - specialiste në Drejtorinë Juridike pranë Departamentit për Shërbimet Mbështetëse.

Besfort Lamallari –Zëvendësministër i Brendshëm

Jeton Xoxa- specialist i Sektorit të Bashkëpunimit, Marrëveshjeve dhe Kontratave  
në Ministrinë e Brendshme

## HAPET MBLEDHJA

**Ulsi Manja** – Përshëndetje të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Kuorumi plotësohet.

Pika e parë e rendit të ditës është miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të datave 10.10.2018 dhe 15.10.2018. A ka vërejtje për procesverbalet? Nuk ka.

Miratohen procesverbalet e datave 10.10.2018 dhe 15.10.2018.

Pika e dytë e rendit të ditës është projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Zogaj (Republika e Shqipërisë) – Skje (Mali i Zi) për qarkullimin ndërkombëtar rrugor dhe të pasagjerëve në liqenin e Shkodrës”. Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi. Relator është kolegu Çyrbja.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Brendshme zonja Rovena Voda, zëvendësministre e Brendshme, zoti Xhevahir Karaj, drejtor i Kufirit në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin, zoti Shkëlzen Rexhepi, shefi i Zyrës Kombëtare të EUROPOL-it dhe zonja Anisa Boci, specialiste në Drejtorinë Juridike pranë Departamentit për Shërbimet Mbështetëse.

Zonja Voda, mirë se keni ardhur në komision së bashku me stafin!

Dua të na bëni një prezantim të shkurtër të kësaj marrëveshjeje për komisionin dhe opinionin publik, pastaj fjalën e ka relatori zoti Çyrbja.

**Rovena Voda**- Faleminderit, kryetar!

Projektligji që sot është në shqyrtim pranë komisionit tuaj ka për qëllim ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe asaj të Malit të Zi për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Zogaj, nga ana e territorit të Republikës së Shqipërisë, dhe Skje, Mali i Zi, për qarkullimin ndërkombëtar rrugor dhe të pasagjerëve në liqenin e Shkodrës.

Në fakt, shtysë për hapjen e kësaj pike të kalimit kufitar ka qenë mardhënia shumë e mirë ndërmjet dy policive kufitare. Mjafton të them se pika e përbashkët kufitare midis Shqipërisë dhe një vendi tjetër fqinj ka qenë pikërisht ajo e Muriqanit, që në vitin 2008, e cila ka bërë të mundur lehtësimin e pasagjerëve dhe mallrave ndërmjet dy vendeve.

Duke e çmuar gjithmonë e më shumë rritjen e fluksit të pasagjerëve, por edhe të mallrave në të dyja anët e kufirit, sipas një vlerësimi që është bërë nga të dy vendet, që, në fakt, iniciatore ka qenë pala e Malit të Zi, nga ne është bërë një vlerësim dhe është parë me vend që

për të lehtësuar lëvizjen e pasagjerëve, por edhe të mallrave në të dyja anët, kryesisht në anën e liqenit të Shkodrës, duke menduar që do të rrisë pjesën e turizmit të asaj zone, kemi shprehur dakordësinë tonë dhe sot jemi para jush pikërisht me këtë marrëveshje, e cila është negociuar midis vendeve, që unë mendoj se do të ketë vetëm impakt pozitiv të banorët e asaj zone, të Bashkisë së Shkodrës dhe të Malësisë së Tivarit.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Voda!

Urdhëroni, zoti Çyrbja!

**Jurgis Çyrbja** – Faleminderit, zoti kryetar!

Ky ligj ka si qëllim ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Zogaj– Skje (Mali i Zi) për qarkullimin ndërkombëtar rrugor të pasagjerëve në Liqenin e Shkodrës.

Zbatimi i kësaj marrëveshjeje do të sjellë lehtësimin e lëvizjes së banorëve të zonës afër Bashkisë së Shkodrës dhe zonave të malësisë së Krajës, komuna Tivar, Mali i Zi, në të dyja anët e kufirit; shkurtimin e distancës, e cila ndikon gjatë sezonit turistik në uljen e fluksit të hyrjeve dhe daljeve në pikën e përbashkët të kalimit kufitar Muriqan; kontrollin më të mirë të sektorit të kufirit në zonën e Zogajt; veçanërisht kontrollin e bregut të Liqenit të Shkodrës, si dhe shfrytëzimin e vlerave turistike të Liqenit të Shkodrës dhe traditën e banorëve të malësisë së Tivarit.

Si përfundim, në aspektin ligjor vlerësoj se ky projektligj është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, ndërsa në aspektin procedural projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit. Në këto kushte u kërkoj kolegëve të komisionit ta miratojnë këtë projektligj.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Çyrbja!

Ka pyetje dhe diskutime nga kolegët? Nuk ka.

Atëherë kalojmë në votimin e kësaj marrëveshjeje në parim.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim kjo marrëveshje.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Zogaj (Republika e Shqipërisë) – Skje (Mali i Zi), për qarkullimin ndërkombëtar rrugor dhe të pasagjerëve në liqenin e Shkodrës.

Bashkë me raportin kjo projekt marrëveshje t’i përcillet Komisionit përgjegjës dhe më pas seancës plenare për votim.

Këtu përfundojmë diskutimet për pikën e dytë të rendit të ditës.

Falënderoj zonjën Voda dhe stafin e saj!

Ditë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 22. 10. 2018, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja - kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Bashkimit Evropian për bashkëpunimin e zbatimit të ligjit, mbi vendosjen e oficerit ndërlidhës të Europol-it”

#### **Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina, Xhemal Qefalia.

#### **Mungojnë:**

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Silva Caka, Astrit Veliaj dhe Tom Doshi.

#### **Të ftuar:**

Besfort Lamallari – Zëvendësministër i Brendshëm

Jeton Xoxa - Specialist i Sektorit të Bashkëpunimit, Marrëveshjeve dhe Kontratave në Ministrinë e Brendshme.

**Ulsi Manja** - Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës, projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Bashkimit Evropian për Bashkëpunimin e Zbatimit të Ligjit, mbi vendosjen e oficerit ndërlidhës të Europol - it”.

Ne jemi komision për dhënie mendimi, kurse relator është kolegu Alket Hyseni! Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Brendshme zoti Besfort Lamallari, zëvendësministër dhe zoti Jeton Xoxa, specialist i Sektorit të Bashkëpunimit, Marrëveshjeve dhe Kontratave në Ministrinë e Brendshme.

Zoti Lamallari, mirë se keni ardhur në komision! Ju lutem bëni shkurtimisht për kolegët e mi dhe opinionin publik një prezantim të këtij projektligji.

Më pas do ta marrë fjalën kolegu Hyseni.

Fjala është për ju.

**Besfort Lamallari** - Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje të nderuar deputetë,

I nderuar kryetar,

Kjo është një nismë e iniciuar nga Europol-i mbi bazë të marrëveshjes që ne kemi tashmë të amenduar ku është shtuar edhe fusha e veprimtarisë së bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe Europol-it.

Është marrëveshje tejet e rëndësishme pasi ardhja në Tiranë e oficerit ndërlidhës të Europol-it i jep një shtysë të re bashkëpunimit ndërkombëtar kryesisht me Europol-in, por edhe me vendet e tjera anëtare të Bashkimit Evropian. Roli dhe detyrat e oficerit ndërlidhës në kuadër të kësaj marrëveshjeje do të jenë bashkërendimi dhe bashkëpunimi në parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe formave të tjera të krimit ndërkombëtar, si dhe lehtësimi i shkëmbimit të informacioneve ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Europol-it, por edhe Shqipërisë dhe vendeve anëtare të Bashkimit Evropian.

Marrëveshja e propozuar përbëhet nga 9 nene dhe detajon të gjitha aspektet e bashkëpunimit, shkëmbimit të informacionit, si dhe ku do të vendoset oficeri ndërlidhës dhe imunitetit. Është një nismë shumë e rëndësishme pasi, siç e thashë, i jep një shtysë goxha të konsiderueshme bashkëpunimit ndërkombëtar në luftën kundër krimit të organizuar.

Faleminderit, zoti Lamallari.

Po, zoti Hyseni.

**Alket Hyseni** – Faleminderit, zoti kryetar!

Projektligji që ka ardhur për miratim është i rëndësishëm nga pikëpamja teknike, për të cilën zëvendësministri sapo foli, por edhe nga pikëpamja politike.

Nga pikëpamja teknike është i rëndësishëm, sepse nëpërmjet mekanizmave të shkëmbimit të ndihmës së ndërsjellë dhe vendosjes së oficerëve të kontaktit, me të njëjtat kushte dhe privilegje si me vendet e tjera anëtare, e bën bashkëpunimin më operacional dhe më frytdhënës. Nga ana tjetër, është i rëndësishme nga pikëpamja politike për të treguar se Republika e Shqipërisë po e ngre nivelin e bashkëpunimit jo vetëm me këtë organizatë, por në përgjithësi me të gjitha strukturat homologe ndërkombëtare me synim goditjen e krimit të organizuar dhe çdo formë të krimit.

Sikurse jeni në dijeni, edhe ditët e fundit, falë bashkëpunimeve me partnerët ndërkombëtarë, Ministria e Brendshme ka realizuar një sërë suksesesh të rëndësishme në goditjen e krimit të organizuar. Sot jemi dëshmitarë të një deklarate për shtyp të Ministrisë së Brendshme. Në vijimësi ka pasur goditje të grupeve kriminale dhe personave me apo po suporte politike. Nuk ka më në Shqipëri persona me imunitet, nuk ka më njerëz të paprekshëm nga fuqia e ligjit.

Ky është tregues që Partia Socialiste nuk bën kompromis me zbatimin e ligjit dhe të bërit shtet. Me të drejtë, njerëzit besojnë te Partia Socialiste, sepse karakteri i qeverisjes së saj është forcimi i strukturave shtetërore dhe përballë shtetit dhe ligjit, të gjithë janë të barabartë.

Prandaj, kolegë të komisionit, ju ftoj ta miratojmë këtë marrëveshje, e cila nga pikëpamja formale dhe procedurale vjen në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Rregulloren e Kuvendit.

Ju faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Hyseni!

Ka pyetje nga kolegët?

Po, zoti Fino.

**Bashkim Fino** – Faleminderit!

Është marrëveshje që duhet mbështetur, por dua të bëj një pyetje, më tepër për kulturë.

Te neni 1, zoti zëvendësministër, keni përcaktuar që palët bien dakord për vendosjen e një ose më shumë oficerëve ndërlidhës, që do të thotë se ne biem dakord që të vijnë oficerë të Europol-it, mund të vijnë 1,2,5,10 oficerë, kjo pak rëndësi ka. Kjo do të zgjidhet nga ju. Kjo ishte e para.

E dyta, te neni 5, kam përshtypjen që kjo është një rutinë që e vendosni ju, por gjithsesi unë doja një shpjegim. Ju thoni se parashikohet përjashtimi nga të gjitha detyrimet doganore, ndalimet dhe kufizimet në import dhe eksport për mallrat për përdorim zyrtar. Këta njerëz të Europol-it një zyrë do të kenë dhe në bashkëpunim me ne. Ç'mallra të tjera mund të kenë për



t'i përjashtuar nga Europol-i? Ose duhet t'i vini të detajuara se cilat mallra duhen hequr nga tarifat doganore.

**Ulsi Manja** – Zoti Lamallari, një përgjigje, të lutem!

**Besfort Lamallari** – Faleminderit për pyetjen, deputet!

**Ulsi Manja** – Ju lutem, pak qetësi!

**Besfort Lamallari** – Për sa i përket pyetjes së parë, është lënë hapësira, një ose më shumë, në varësi të nevojës së rritjes së bashkëpunimit ndërkombëtar, por, aktualisht, mes palëve është biseduar vetëm për një oficer. Europol-i ka proceduar dhe mbetet që tashmë të ezaurohen hapat e brendshëm deri te njoftimi i Europol-it për përfundimin e procesit të ratifikimit. Më pas, përmes një note, Europol-i i dërgon Ministrisë së Jashtme, përmes delegacionit të BE-së, njohjen e imuniteteve dhe privilegjeve, e cila është e barabartë me të gjithë ata përfaqësues diplomatikë në Shqipëri, siç e përmend edhe neni 3, që gëzojnë të tilla privilegje dhe imunitet në Shqipëri, në kuadër të Konventës së Vjenës mbi marrëdhëniet diplomatike. Mbi bazë të kësaj, bëhet edhe njohja e përjashtimeve doganore. Bëhet fjalë vetëm për produkte zyrtare, pra që prokurohen nga Europol-i, pra kompjuterë, materiale ndihmëse, pajisje, për të cilat mund të ketë nevojë oficeri ndërlidhës. Gjithmonë, vetëm për produkte...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

...që janë me regjim të përkohshëm për Europol-in.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Lamallari!

Ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka.

Diskutime? Nuk ka.

Kalojmë te votimi në parim.

Kush është dakord në parim me këtë projekt marrëveshje?

Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet në parim projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Bashkimit European për bashkëpunimin e zbatimit të ligjit, për vendosjen e oficerit ndërlidhës të Europol-it.”

Kalojmë te votimi nen për nen.

Neni 1.

Pro?

Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 1.

Neni 2.

Pro?

Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 2.

Kalojmë te votimi në tërësi.

Kush është dakord në tërësi?

Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet edhe në tërësi ky projektligj.

Raportin, së bashku me sugjerimet e kolegëve, relatori t'ia përcjellë komisionit përgjegjës dhe më pas seancës plenare për votim.

Me miratimin e kësaj projekt marrëveshjeje e mbylлим mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme.

Mbledhja e radhës, së bashku me rendin e ditës, do t'ju njoftohet nga sekretaria e komisionit.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

Faleminderit, zoti Lamallari, së bashku me stafin!

## **MBYLLET MBLEDHJA**